



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim për shtyp

Mbi autorizimin e përqëndrimit Albanian Airlines Mak shpk-Advanced
Construction Group shpk
dhe vendosjen e gjobës ndaj shoqërisë Albanian Airlines Mak shpk

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 17.09.2009 shqyrtoi raportin mbi autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të kuotave të shoqërisë Albanian Airlines MAK SH.p.k. nga shoqëria Advanced Construction Group Sh.p.k.

Përqëndrimi i realizuar konsiston në ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Albania Airlines Mak shpk në kuptim të nenit 10, pika 1, gërma b e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji) dhe ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqëndrim plotësojnë edhe kushtet e xhiros në tregun e brendshëm të përcaktuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit.

Pas realizimit të përqëndrimit, struktura e tregut nuk ndryshon pasi në kuptim të nenit 10, pika 1, gërma b kemi zëvendësim të pronësisë dhe blerësi do të ruajë dhe do të ndihmojë në zhvillimin e profilit tregtar të shoqërisë Albanian Airlines.

Nga analiza e konkurrencës, përqëndrimi i realizuar nuk ndryshon strukturën e tregut pas përqëndrimit dhe si pasojë nuk krijon apo forcon pozitën dominuese në tregun përkatës dhe për këto arsye Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Albanian Airlines MAK SH.p.k. nga shoqëria Advanced Construction Group Sh.p.k.

* * *

Në mbledhjen e datës 18.09.2009, Komisioni i Konkurrencës me shumicë votash ka marrë vendimin nr 123 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë Albanian Airlines MAK sh.p.k”.

Procedurat e kontrollit të përqëndrimit të realizuar, për shkak të mosnjoftimit nga palët, është filluar me vendim të Komisionit të Konkurrencës nr. 100, datë 03.02.2009. Shoqëria nuk i është përgjigjur Autoritetit të Konkurrencës për plotësimin e informacionit edhe pse Komisioni i Konkurrencës i ka rikërkuar të dhënat me vendimin Nr. 112, datë 15.05.2009 “Për tërheqje të dhënash nga shoqëria Albanian Airlines Mak Sh.p.k.”

Me datë 26 korrik 2009 Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 39 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dëgjoi palët për pretendimet e tyre lidhur me shkeljet e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” lidhur me përqëndrimin e realizuar. Palët kërkuar 15 ditë kohë për të paraqitur provat e tyre por edhe pas

përfundimit të këtij afati pranë Autoritetit të Konkurrencës nuk është depozituar asnjë shkresë nga palët pjesëmarrëse në përqëndrimin e realizuar.

Nga analiza e konkurrencës konstatohet se përqëndrimi i realizuar nuk sjell pasoja për konkurrencën në treg. Por palët pjesëmarrëse në përqëndrim kanë shkelur ligjin me mosnjohimin e përqëndrimit, realizimin e përqëndrimit duke mos respektuar detyrimin ligjor dhe mos depozitim të informacionit të plotë dhe në afat.

Sa më lart, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 73, pika 1, shkronja b, vendosi me shumice votash gjobitjen e shoqërisë Albanian Airlines MAK shpk në masën 2 600 000 lekë.

Ky vendim ka patur edhe një mendim pakice.

Në bazë të nenit 80 të Ligjit ngarkohet Njësia e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për mbledhjen e gjobës.